

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti i Sherbimit:

Objekt i Sherbimit do te jete **Ruajtja e objekteve te Drejtorise se Shendetit Publik Has dhe Spitalit Has me Sherbim Privat te Sigurise Fizike per periudhen shkurt-dhjetor 2017**, duke garantuar paprekshmerine e tyre fizike (pasurive te luajtjeshme dhe te paluajtjeshme).

Te dhena per sherbimin e kerkuar:

Sherbimi do te kryehet me nje vend-roje ne hyrjen kryesore me tre turne, sherbim -24 ore panderprerje.

Gjate sherbimit te kontrollohet hyrja kryesore dhe pjesa e pasme e objekteve, dera e pasme e institucioneve.

Gjate turneve te dyta dhe te treta rojet te kryejne kontrolle cdo 15 minuta ne te gjitha hapesirat e objekteve.

Rojet e turnit te trete te jete te pajisur me arme.

Kapaciteti Teknik e Profesional per Kryerjen e Sherbimit:

Sherbimi i Ruajtjes se objekteve do te kryhet nga Kontraktuesi, i Licencuar per kryerjen e Sherbimit Ruajtjes dhe Sigurise Fizike te Objekteve Ne zbatim te Ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2015 duhet te kete ne stafin e Shoqerise Drejtues Teknik te Licensuar.

Ky sherbim do te kryhet nepermjet punonjesve te Sherbimit (rojeve) te cilet duhet te jene te licensuar nga Drejtoria e Policise Vendore Kukes.

Lejet e Ushtrimit te Profesionit te leshuar nga Drejtoria e Policise Vendore, sipas Udhezimit, duhet te korespondoje me vendndodhjen e kryerjes se sherbimit.

Punonjesit e sherbimit veç Licensimit, duhet te kene “kaluar” sukseshem trajnimet perkatese.

Punonjesit e Sherbimit gjate kryerjes se tij (ne turnin e III-te), duhet te jene te pajisur me armatim (sipas udhezimeve nga drejtorite e policise), e te pajisur me lejen e perdorimit te tyre, si dhe mjete te tjera mbrojtese (shkop gome, mbrojtese antiplumb, ... etj).

Punonjesit e Sherbimit gjate kryerjes se tij, duhet te jene te pajisur me radionderlidhje, vrojtime, radioalarme. Kontraktuesi duhet te garantoje mbulim te te gjithë territorit te ne cilat jane te vendosura objektet, 24 ore.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Ruajtja e objekteve të Drejtorisë së Shëndetit Publik Has dhe Spitalit Has me Shërbim Privat të Sigurisë Fizike për periudhën shkurt-dhjetor 2017

Numri i vendrojeve është 1 (një) me 4.7 (katërpikështatë) roje.

| Numri i vendrojeve | Numri i turneve | Numri i rojeve të nevojshme | Afati i kontratës | Fondi Limit pa TVSH | Fondi Limit me TVSH |
|--------------------|-----------------|-----------------------------|-------------------|---------------------|---------------------|
| 1 | 3 | 4.7 | 11 muaj | 2.585.000 | 3.102.000 |

Fondi limit me TVSH i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shëndetit Publik Has është 822.500 leke pa TVSH ose 987.000 leke me TVSH

Fondi limit me TVSH i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has është 1.762.500 leke pa TVSH ose 2.115.000 leke me TVSH

Grafiku i pagesave të faturave do të jetë **Spitali Has** do të paguajë për periudhën shkurt-mars-prill-maj-qershor-korrik-gusht 2017 si dhe 1-15 shtator 2017.

Grafiku i pagesave të faturave do të jetë **Drejtoria e Shëndetit Publik Has** do të paguajë për periudhën 16-30 shtator 2017 si dhe muajt tetor-nëntor-dhjetor 2017.

Shërbimet do të kryhen për 24 orë me roje në:

Godina e Drejtorisë së Shëndetit Publik Has me adresë kryesore Rruga: Rruga e Spitalit, Qyteti Krume.

Godina e Spitalit Has me adresë kryesore Rruga: Rruga e Spitalit, Qyteti Krume.

Godina e DSHP-së Has, Godina e Spitalit Has, garazhdet dhe asetet e tjera që ka në administrim Drejtoria e Shëndetit Publik Has dhe Spitali Has do të ruhen me roje private të armatosura duke realizuar objektivat dhe detyrat e përcaktuara në kontratë. Të sigurojë dhe të ruajë ambientet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i Drejtorisë së Shëndetit Publik Has dhe Spitalit Has nga demtimet, vjedhjet, e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të administratës dhe të punonjësve të saj. Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi dhe me kartën e identitetit personal për çdo punonjës shërbimi.

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim si dhe për parandalimin e ndalimin e veprimtarisë së keqberësve në dem të objektit që ka nën ruajtje dhe nën përgjegjësi personale të tij.

Shërbimi i ruajtjes së sigurimit fizik të objekteve do të jetë 24 orë për çdo ditë kalendarike, sipas afatëve të kontratës.

Perveç shërbimeve të mesipërme, marrëdhëniet me të detajuara midis kontraktuesit dhe institucioneve do të jepen në rregulloren e posaçme që do të jetë pjesë e kontratës.

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimi do te kryhet per periudhen Shkurt-Dhjetor 2017.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekt i Sherbimit eshte Ruajtja dhe Siguria Fizike e objekteve te Drejtorise se Shendetit Publik Has dhe Spitalit Has.

Qellimi i kryerjes se sherbimit eshte parandalimi i çdo tentative ose veprimi kriminal, qe ka per objekt vjedhjen ose demtimin pasurive te luajtshme e te paluajtshme ne objektet qe Autoriteti Kontraktor ka ne administrim. Te siguroje dhe te ruaje ambientet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i Drejtorise se Shendetit Publik Has dhe Spitalit Has nga demtimet, vjedhjet, e mundshme si dhe punen normale te administrates dhe te punonjesve te saj.

Kjo do te realizohet nga Rojet te cilet gjate kryerjes se sherbimit do te:

- jene te armatosur e mjete te tjera mbrojtese,
- jene te pajisur me radio-transmetuese qe do te funksionojne sipas percaktimeve te Liçenses per Ngritje dhe Shfrytezim Sistemi te Pavaruar Radiokomunikacioni, me te cilen Shoqeria eshte pajisur nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.
- jene te veshur me uniforme ne te cilen do te jene vendosur Stema dalluese e Shoqerise.

Shoqeria e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike në perputhje me Ligjit per kryerjen e Sherbimit DUHET te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive,etj.

Objektivat: Të ruaj me përkushtim objektin që i është besuar, të ruaj rendin në to, si dhe të sigurojë jetën e personelit.

Shpërndarja: Objekte/asetet e **Drejtorise se Shendetit Publik Has** qe kerkohen te ruhen nga shoqeria e ruajtjes dhe sigurise fizike jane :

1. Godina e DSHP-se Has
2. Ambjente sherbimi te shendetit publik
3. Garazhdet e DSHP-se

Objekte/asetet e **Drejtorise se Sherbimit Spitalor Has** qe kerkohen te ruhen nga shoqeria e ruajtjes dhe sigurise fizike jane :

1. Godina e Spitalit Civil Krume
2. Ambjente sherbimi spitalore
3. Garazhdet e spitalit
4. Lavanderia e spitalit
5. Territori para dhe pas spitalit Has
6. Zona e gjelbruar, lulishtet dhe pemet
7. Muri rrethues i spitalit Has

Detyrat: Rojet civile do te ruajne me perkushtim objektin qe i eshte besuar, do te ruajne rendin ne to si dhe do te sigurone jeten e personelit punonjes te Autoritetit Kontraktor gjate orarit zyrtar te punes.

Kjo do te realizohet nga Roja (et) Civile nepermjet zbatimit te detyrave te meposhteme :

- Nuk do te lejojne futjen e personave ne objekt pa flete-hyrje
- Nuk do te lejojne hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumenta shoqerues
- Per persona qe vijne per probleme pune do te njoftoje me pare kerkuesin dhe vetem me lejen e Tij do ta shoqeroje tek personi i kerkuar
- Roja per marrjen e detyres do te paraqitet 15 minuta para. Nuk do te largohet nga vendi i kryerjes se sherbimit pa u zevendesuar dhe pa marre miratimin e Drejtuesit Teknik ose Pergjegjesit te Rojeve.
- Gjate turneve te dyta dhe te treta Rojet do te kryejne kontrole çdo 15 minuta, ne te gjithë hapsirat e objekteve.
- Para marrjes e Sherbimit, do te kontrolloje objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per çdo ç’regullim te konstatuar do te njoftoje pergjegjesin e rojeve dhe Ate te objektit, si dhe do te beje shenimet perkatese ne Librin e Sherbimit.
- Do te kujdeset per ndriçimin e jashtem te objektit duke ne dijeni pergjegjesin e Tij.
- Ne rast zjarri do te marre masat per shuarjen e tij dhe menjehere do te njoftoje M.K.Z., si dhe pergjegjesin e Objektit.
- Do te kerkojne nga shtetasit dhe punonjesit qe te zbatojne rregullat e brendeshme te objektit.
- Ne rast se ne objekt do te kryhen vepra penale, roja do te beje bllokimin e mjedisit dhe te autorit, si dhe do te njoftoje menjehere organet kompetente.
- Perdorimi i Armes nga Roja do te behet vetem per rastet e parashikuara nga Ligji.
- Roja per realizimin e detyrave dhe objektive te tij do te bashkepusoje me Policine e Rendit, Komisariatin e Policise Has.
- Roja gjate kryerjes se Sherbimit nuk do te futet dhe nuk do te qendroje ne ambjentet e brendeshme te objektit, me perjashtim te rasteve kur futja dhe qendrimi ne keto ambjente kerkohet per zbatimin e Rregullores.
- Do te karakterizohet nga sjellje qytetare ne komunikim me personelin punonjes si dhe me personat e trete.
- Roja gjate kryerjes se Sherbimit, nuk do te “konsumoje” pije alkolike, nuk do te fleje si dhe nuk do te bisodoje me persona te jashtem.
- Roja do te zbatoje vetem urdherat e pergjegjesit te rojeve dhe titullareve (pergjegjesave) te objekteve perkates.
- Ne çdo vend roje do kete keto Dokumenta :
 1. Rregullorja e brendeshme
 2. Libri i marrjes ne dorezim te Sherbimit
 3. Grafiku i Sherbimit
 4. Inventari i materialeve qe ndodhen ne objekt
 5. Mjete ndriçimi ne rast mungese energjie elektrike
 6. Numrat telefonik te Komisariatit te Policise Has, M.K.Z, dhe te personave kryesor pergjegjes te objekteve.
 7. Skemen e njoftimit ne rast sulmi ose zjarri ne objekt.
 8. Listen e automjeteve qe lejohen te hyjne apo te parkohen ne objekt.

- Gjate kryerjes se Sherbimit Roja nuk do te beje telefonata private.
- Per probleme urgjente te Sherbimit, Roja do te perdore mjetet e nderlidhjes se objektit.
- Grafiku i nderrimit te Sherbimit do te behet vetem me miratim te Pergjegjesit te Rojeve.
- Çdo levizje e personelit apo personave te tjere do te shenohet ne librin e Sherbimit

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Drejtoria e Shendetit Publik Has, me adrese rruga e Spitalit, Qyteti Krume, Bashkia Has.

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has, me adrese rruga e Spitalit, Qyteti Krume, Bashkia Has.

